



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN

Nr. _____ prot.

Elbasan, më ____ . ____ . 2019

SHTOJCE

Mbi një ndryshim në dokumentat standarte të tenderit

Autoriteti Kontraktor, Bashkia Elbasan, **bazuar në rekomandimin e APP-së datë 21.01.2019** vendosi që të bëjë disa ndryshime në dokumentat standarte të tenderit, për procedurën me nr. REF- 04317-01-18-2019, me objekt **“Kryerja e shërbimit të pastrimit në qytetin e Elbasanit” - Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 18 muaj**, me fond limit **109.865.304,35** (njëqind e nëntë milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e pesëmijë e treqind e katër presje tridhjetë e pesë) **lekë** (pa tvsh), i publikuar me datë 21.01.2019 në faqen e internetit të APP-së. Sa më sipër, bazuar në nenin 42 të ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Autoriteti Kontraktor, Bashkia Elbasan, njofton se dokumentave të tenderit i bëhen këto ndryshime si më poshtë:

1. **Tek kriteret e veçanta për kualifikim - Kapaciteti Teknik, në pikën 6 - Disponimi ose mundësia e sigurt e disponimit në paisjet/kapacitetet e mëposhtme teknike, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës, paragrafi i parë ndryshohet si mëposhtë:**

- Ishte

Per transportimin e mbjetjeve urbane me mjet teknologjike kerkohen 5 mjete te cilat te jene te vitit te prodhimit pas vitit 2005.

- Bëhet

Për transportimin e mbetjeve urbane operatori duhet të disponojë 5 mjete teknologjike.

2. **Tek kriteret e veçanta për kualifikim - Kapaciteti Teknik, pika 7 - ndryshohet si mëposhtë:**

- Ishte

Operatori ekonomik duhet të vërtetojë disponimin e mjeteve kontenierë, në pronësi ose me qera minimalisht 650 kontenierë të mbetjeve urbaneme volum 1.1 m³, metalik, të zinguar,

të rinj me vit prodhimi jo më poshtë se 2015. Në rast se janë me qera, kontrata e qerasë duhet të jetë noteriale dhe të përmbajë objektin dhe afatin e marrjes me qera të kontenierëve .

- Bëhet
 - **Operatori ekonomik duhet të vërtetojë disponimin e mjeteve kontenierë, në pronësi ose me qira minimalisht 650 kontenierë të mbetjeve urbane me volum 1.1 m³, metalik, të zinguar, të rinj me vit prodhimi jo më poshtë se 2015. Në rast se janë me qira, kontrata e qirasë duhet të jetë noteriale dhe të përmbajë objektin dhe afatin e marrjes me qera të kontenierëve. Për të vërtetuar disponimin e kontenierëve operatori ekonomik duhet të paraqesë faturë tatimore shitje ku të jenë shënuar saktë datat, shumat, sasi të mallrave të furnizuara dhe emri e nënshkrimi i personit blerës ose faturë zhdoganimi në emër të vet ose të qeramarrësit (në rastin kur merret me qera).**
3. **Tek kriteret e veçanta për kualifikim - Kapaciteti Teknik, në pikën 6 - Disponimi ose mundësia e sigurt e disponimit në paisjet/kapacitetet e mëposhtme teknike, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës, paragrafi i gjashtë,** ku kërkohet që operatori ekonomik duhet të verë në dispozicion për plotësimin e detyrave mjete dhe pajisje: Fshesë (duhet të jetë e butë, e përthyeshme dhe elastike, prej materiali plastik, shqop ose gjineshtër) , lopata (të pershtatshme për këtë proces pune), hiqet.

Ky ndryshim do të jetë i detyrueshëm për të gjithë operatorët ekonomike që do të paraqesin ofertë. Data e zhvillimit të tenderit dhe afati përfundimtar për dorëzimin e ofertave për shkak të këtij ndryshimi do të shtyhet me **5** (pesë) ditë.

Data e re për zhvillimin e tenderit dhe afati përfundimtar për dorëzimin e ofertave do të jetë **19.02.2019 ora 10.00.**

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
PERSONI I AUTORIZUAR PREJ TIJ
Zv.Kryetari
Klaudia Krasnika**